

## SHTATZËNAT MUND TË VAKSINOHEN FALAS KUNDËR GRIPIT!

## ÇAKTO NJË AFAT VAKSINIMI PËRMES UEB PLATFORMËS!

Terminet për vaksina falas bëhen përmes ueb-  
faqes:

[www.vakcinacija.mk](http://www.vakcinacija.mk)

Duke plotësuar formularin, ju regjistroni për  
vaksinim, direkt në sistemin Moj Termin. Me anë  
të një mesazhi SMS, do të merrni informacion për  
datën dhe orën e saktë të vaksinimit në pikën që  
zgjidhni gjatë regjistrimit.

Përveç kësaj, ju mund të merrni një vaksinë  
komerciale të gripit sezonal në Qendrën tuaj më të  
afërt të Shëndetit Publik pa paraqitje paraprake.

## Ta bëjmë të jetë më mirë!

Nëna të ardhshme,  
vaksinohuni në kohë sepse  
gripit është një sëmundje e  
rëndë që mund të jetë  
kërcënuese për shëndetin tuaj  
dhe të fëmijëve tuaj!



## A JENI SHTATZËNË?

KENI NEVOJË PËR VAKSINË  
KUNDËR GRIPIT!

ÇDO GRUA SHTATZËNË  
DUHET TË VAKSINOHET  
PËR TË MBROJTUR VETEN  
DHE FËMIJËN E SAJ!

Gripit mund të jetë një sëmundje  
e rëndë dhe të shkaktojë probleme  
serioze shëndetësore, veçanërisht  
nëse jeni shtatzënë.

Edhe nëse një grua  
shtatzënë në përgjithësi  
është e shëndetshme,  
ndryshimet në sistemin  
imunitar, funksionet e  
zemrës dhe të mushkërive  
që mund të shkaktojë virusi  
i gripit gjatë shtatzënisë  
mundësojnë që sëmundja  
të përparojë në një formë të  
rëndë të gripit.



Prandaj, nëse jeni shtatzënë, vakcina kundër gripit rekomandohet në çdo periudhë të shtatzënisë sepse:

- ◆ zvogëlon rrezikun që të sëmurëni me grip
- ◆ mbron fëmijën tuaj nga gripin edhe disa muaj pas lindjes!

Gratë shtatzëna (dhe gratë pas lindjes, deri në dy javë pas lindjes) që fitojnë gripin janë në rrezik më të madh për të zhvilluar sëmundje serioze, që mund të sjellë deri në shtrimin në spital. Një studim nga viti 2018 zbuloi se marrja e një vaksine kundër gripit zvogëlon rrezikun e shtrimit në spital tek gratë shtatzëna me grip mesatarisht rreth 40%.



## Vaksina e gripit është mbrojtja më e mirë për një grua shtatzënë dhe foshnjën e saj!

Pas marrjes së vaksinës së gripit, organizmi i gruas shtatzënë fillon të krijojë antitrupa, të cilët ndihmojnë në parandalimin e gripit.

Antitruapat kalojnë tek fetusin në zhvillim, duke ndihmuar në mbrojtjen e tij nga gripin për disa muaj pas lindjes. Kjo është e rëndësishme sepse foshnjat nën moshën 6 muajsh janë shumë të vegjël për të marrë vaksinën e gripit (vakcina u jepet vetëm fëmijëve mbi 6 muajsh).

Gjithashtu, antitruapat mund të barten tek të porsalindurit përmes qumështit, nëse nëna e ushqen fëmijën me gjë - pavarësisht nëse e ka marrë vaksinën gjatë shtatzënisë apo pas lindjes.



## VAKSINAT E GRIPIT JANË TË SIGURTA PËR GRATË SHTATZANË DHE NËNAT QË USHQEJNË ME GJI.

*Nëse fëmija juaj lind para se të vaksinoheni kundër gripit, nuk është vonë dhe duhet të vaksinoheni edhe më pas!*

Miliona gra shtatzëna në mbarë botën marrin vaksinën e gripit çdo vit! Vaksinat kanë një rekord të shkëlqyer nga aspekti i sigurisë, dhe studime të shumta e kanë vërtetuar këtë.

Vaksina e gripit nuk mund të shkaktojë grip.

## EFEKTET ANËSORE TË ZAKONSHME NGA VAKSINA E GRIPIT JANË TË LEHTA.

Është e mundur të shfaqen disa efekte anësore të lehta pas marrjes së vaksinës së gripit. Efektet anësore më të zakonshme janë një reaktion lokal në vendin e aplikimit në formën e dhimbjes, ndjeshmërisë, skuqjes dhe/ose ënjtjes. Më rrallë, disa gra shtatzëna mund të përjetojnë dhimbje koke, dhimbje muskujsh, ethe dhe vjellje ose ndjenjë të lodhjes. Të afërmit e gruas shtatzënë dhe të foshnjës së saj duhet të vaksinohen kundër gripit!